



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT DHE UJIT

V E N D I M

Nr. 71, datë 25.09.2025

**PËR KONFISKIMIN PËR INTERES PUBLIK TË OBJEKTIT TË NDËRTUAR PA
LEJE NDËRTIMI ME QËLLIM FITIMI: "OBJEKT 9 KATE + 4 KATE + 2 KATE
NËNTOKË", ME VENDNDODHJE NË BASHKINË FIER**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar, Ligjit Nr. 66/2023 "Për administrimin e objekteve të konfiskuara si ndërtime pa leje, me qëllim përdorimin e tyre për interes publik apo strehim social, si dhe zbutjen e pasojave sociale të shkaktuara", Vendimit Nr. 589, datë 7.9.2022 "Për rregullat dhe procedurat për konfiskimin për interes publik të objekteve të ndërtuara pa leje, për qëllim fitimi", Vendimit Nr. 6, datë 18.06.2025 të Komisionit të Objekteve të Konfiskuara, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.519, datë 20.09.2017 "Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit", i ndryshuar, me propozim të Inspektoriatit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit (IKMT), Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit,

VENDOSI:

1. Konfiskimin për interes publik të objektit të ndërtuar pa leje ndërtimi me qëllim fitimi: "Objekt 9 kate + 4 kate + 2 kate nëntokë", me vendndodhje në Bashkinë Fier, me subjekt zhvillues shoqërinë "Ufo" sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave i bashkëlidhet këtij vendimi si pjesë përbërëse e tij.
3. Autoriteti përfitues i konfiskimit ose subjekti zhvillues, sipas rastit, aplikon nëpërmjet sistemit e-leje, pranë Sekretariatit Teknik të KKTU-së, për miratimin e lejes përkatëse sipas përcaktimit të dispozitave ligjore të Ligjit Nr. 66/2023, "Për administrimin e objekteve të konfiskuara si ndërtime pa leje, me qëllim përdorimit të tyre për interes publik apo strehim social, si dhe zbutjen e pasojave sociale të shkaktuara", dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.
4. Pas miratimit të lejes përkatëse, Agjencia e Zhvillimit të Territorit të lëshojë certifikatën e përdorimit, në përputhje me këtë vendim dhe planvendosjen bashkëlidhur.

HILLI I MINISTRAVE

5. Agjencia Shtetërore e Kadastrës të kryejë regjistrimin e këtij vendimi, së bashku me certifikatën e përdorimit, sipas parashikimeve në VKM-në Nr. 589, datë 7.9.2022 “Për rregullat dhe procedurat për konfiskimin për interes publik të objekteve të ndërtuara pa leje, për qëllim fitimi”.
6. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me autoritetin përgjegjës për rregullimin e pasojave të konfiskimit, për zbatimin e këtij vendimi.
7. Vendimi, pasi nënshkruhet nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, Ministri i Punëve të Brendshme, Ministri i Ekonomisë dhe Inovacionit dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit, hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDH RAMA



ANËTAR/MINISTËR I PUNËVE TË BRENDSHME

BESTORTI ENVALEARI



ANËTAR / MINISTËR I EKONOMISË DHE INOVACIONIT

DELINA IBRAHIMAJ



ANËTAR / SEKRETAR I KKTU-SË

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

ADELAJDA ROKA



Nënshkruar më datë 10/07 / 2026